



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

08.10.2021

NR.
5846/2**AKT-MIRATIMI****ORGAN I MIRATUAR I VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT.**

Mbështetur në Kreun V të ligjit Nr. 10489, datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen etregut të produkteve jo ushqimore" i ndryshuar, nenin 4 të ligjit Nr. 32/2016 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion", ligjin Nr. 8734, datë 1.2.2001 "për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike" i ndryshuar, Urdhrin e Ministrit Nr. 53 datë 05.10.2017 "Për miratimin e rregullores "Për procedurat e miratimit dhe mbikëqyrjes së organeve evropiane të notifikuara dhe organeve të miratuara të vlerësimit të konformitetit"", në Certifikaten e Akreditimit me Nr. **TI 036** regjistrimi dhe Certifikaten e Akreditimit me Nr. **CN 011** regjistrimi, datë 30.12.2020

MIRATOJ:

Subjekti:	"SWISS APPROVAL ALBANIA SHPK (FRANCHISE SWISS APPROVAL TECHNISCHE BEWERTUNG SA GREECE)" sh.p.k.
Me Administrator:	Majlinda Tafili
Adresa e subjektit:	Rruga "Sami Frashëri", Ndërtesa Nr. 19, Hyrja Nr.8, 1019, Tiranë.
Tel.:	+355 44 30 95 15
Cel.:	+355 696057977; +355697073002
E-mail:	info@swissapproval.al; mtafili@swissapprove.al

të ushtrijë veprimtarinë si «Organ i Miratuar i Vlerësimit të Konformitetit (OMVK) dhe Organizëm i Certifikimit të Personave»:

Tipi i trupës së inspektimit:	Tipi A
Fusha e Inspektimit:	I. Vlerësim i konformitetit të projekteve teknike dhe teknologjike për produktet/pajisjet/instalimet nën presion. II. Lëshim Vërtetimi Teknik për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e prodhimit, transportimit dhe tregtimit të gazit, naftës dhe nënprodukteve të tyre. III. Miratim i Kartës Teknologjike. IV. Vlerësim konformiteti në fushën e enëve nën presion: - Inspektimi i Pajisjeve nën presion stacionare: - Pajisjet nën presion stacionare. - Tubacionet nën presion (lidhjet teknologjike brenda objektit) - Aksesoret e sigurisë dhe aksesoret nën presion. - Inspektimi i kalidajave me avull dhe ujë të nxehtë

3. Inspektimi i rezervuarëve të gazit të lëngëzuar të naftës (GLN-së) me kapacitet me të vogël ose të barabartë me 13m³
4. Inspektimi i rezervuarëve të gazit të lëngëzuar të naftës (GLN-së) me kapacitet me të madh ose të barabartë me 13m³
5. Inspektimi i enëve nën presion kriogjenike të term izoluara me vakum
6. Inspektim i rezervuarëve mbitokësor të depozitave të hidrokarbureve të lëngët.
7. Inspektim i çisternave automobilistike për transport të mallrave të rrezikshëm.
 - Klasat 2.3.8 të ADR.
 - Klasa 2: gaze.
 - Klasa 3: lëngje të djegshme.
8. Inspektim i kokave të pusit.
9. Inspektim i bombolave të mbushura me GLN.
10. Inspektim i automjeteve që transportojnë bombola të mbushura me GLN.

V. Vlerësim konformiteti në fushën elektrike:

1. Inspektim i instalimeve elektrike në ambiente të zakonshme.
2. Inspektim i instalimeve elektrike në ambiente me rrezik zjarri.
3. Inspektimi i impianteve mbrojtëse nga rrufeja.
4. Inspektimi i kabinave elektrike TM/TU.
5. Inspektimi i linjave ajrore TU e TL.
6. Inspektimi i impianteve shpërndarës TL dhe nënstacioneve (impiantet shpërndarës nën 1000V, mbi 1000V dhe nënstacionet elektrike).
7. Inspektimi i linjave kabllore me tension 20, 10, 6 kV.
8. Inspektimi i fushës elektromagnetike për pajisjet dhe instalimet elektrike.

VI. Vlerësim konformiteti në fushën e mekanike

1. Vinça dhe makineri ngritëse
 - Vinçat lëvizës.
 - Vinçat kullë.
 - Vinça urë dhe me këmbalec.
 - Makineritë ngritëse

VII. Certifikim Personeli për:

Personat që punojnë me pajisjet/instalimet nën presion:

Grupi A, Përdorues/operues/shfrytëzues të rezervuarëve/instalimeve të GLN-së me vëllim deri 13 m³ mbi/nën tokë;

Grupi B, Përdorues/operues/shfrytëzues të rezervuarëve/instalimeve të GLN-së me vëllim mbi 13 m³, mbi/nën tokë;

Grupi C, Përdorues/operues/shfrytëzues të enëve/instalimeve nën presion të pajisjeve teknologjike dhe rezervuarëve të ajrit;

Grupi D, Përdorues/operues/shfrytëzues të kaldajave me avull dhe me ujë/vaj të nxehte;

Grupi E, Përdorues/operues/shfrytëzues të enëve/instalimeve nën presion kriogjenike;

Grupi F, Përdorues/operues të instalimeve të qendrave të mbushjes dhe të magazinimit të bombolave me GLN;

Grupi G, Përdorues/operues për shkarkimin dhe transvazimin së cisternave automobilistike/hekurudhore të GLN-së dhe mallrave të rrezikshëm.

Grupi F, Persona që kanë për detyrë dhe përgjigjen për transportin e bombolave të GLN-së dhe instalimin e tyre tek konsumatori.

Personat që punojnë në impiantet, instalimet, linjat dhe pajisjet elektrike.

A: Personat që përdorin pajisje/implante elektrike lidhur me sigurimin teknik elektrik të klasifikuar në Grupin **I, II, III, IV dhe V**;

B: Instalues dhe mirëmbajtës të pajisjeve, implanteve dhe instalimeve elektrike të tensionit të ulët, (ITU);

C-1: Instalues të autorizuar për linjat ajrore ose nëntokësore me tension të lartë deri 30 kV (përfshirë), **Tipi 1**;

C-2: Instalues të autorizuar për linjat ajrore ose nëntokësore me tension të lartë mbi 30 kV, **Tipi 2**;

D-1: Instalues të autorizuar për instalimet elektrike të tensionit të lartë me tension nominal jo më të madh se 30 kV, **AT1**;

D-2: Instalues të autorizuar për instalimet elektrike të tensionit të lartë pa kufij tensioni, **AT2**.

Personat që punojnë me vinça; makina ngritëse, transportuese dhe të punimit të tokës:

Grupi A-1: Operator të vinçave kullë;

Grupi A-2: Operator të vinçave urë;

Grupi A-3: Operator të vinçave të lëvizshëm;

Grupi B-1: Operator i makinerive ngritëse;

Grupi B-2: Operator i makinave transportuese të stacionuara;

Grupi C-1: Ekskavatorist: (për mjete me goma ose me zinxhirë);

Grupi C-2: Automakinist: autovinça, autobetoniere, autobetonpompa, autobitumatrine, autosonda;

Grupi C-3: Buldozerist, (me rrota ose me zinxhirë).

Ligje/Rregullat teknike/standardet e sigurisë së produktit/pajisjes/instalimit të vënë në shërbim:

1. Ligj Nr.10489, datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore" i ndryshuar.
2. Ligji Nr. 32/2016 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion".
3. Vendim Nr. 1062, datë 23.12.2015 "Për miratimin e rregullit teknik "Për pajisjet dhe bashkësitë nën presion" dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara";
4. Vendim Nr. 1065, datë 23.12.2015 "Për miratimin e rregullit teknik "Enët e thjeshta nën presion" dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara".
5. VKM nr.425, datë.20.05.1996 "Rregulloren për Prodhimin, Instalimin dhe Shfrytëzimin e Rezervuarëve të Gazit të Lëngëzuar të Naftës".
6. VKM 491, datë 19.07.2017 "Për përcaktimin e rregullave, të kushteve teknike dhe normave të mirëmbajtjes së instalimeve nën presion, që shërbejnë për përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre.
7. Urdhër Nr. 315, datë 24.08.2017 "Për procedurat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës dhe nënprodukteve të saj".
8. VKM Nr.1060, date 23.12.2015 – "Për miratimin e rregullit teknik "Për makineritë".
9. Urdhër i Ministrit nr. 184, datë 05.07.2005 "Kushtet teknike dhe normat e projektimit për impiantet dhe instalimet që shërbejnë për transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftës gazit dhe nënprodukteve të tyre.
10. Ligji nr. 9272, datë 16.09.2004 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen Europiane "Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme (ADR)" dhe protokollin e nënshkrimit".

11. VKM Nr. 212 datë 16.03.2016 Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës (GLN).
12. VKM Nr. 245, datë 30.3.2016 “Për miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat teknike në instalimin dhe kontrollin e diapozitivit diferencial, vendosur në pajisjet, impiantet dhe instalimet elektrike” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”.
13. Urdhër Nr. 3403/1 Prot. date 30.06.2003 “Rregullore e Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impiantet, Pajisjet dhe Instalimet Elektrike”, miratuar nga Ministri i Industrisë dhe Energjetikës.
14. Ligji Nr.10 171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”.
15. Ligji Nr.7961, date 12.07.1995, “Për Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë” ndryshuar me Ligjin Nr.8085, datë 13.03.1996, dhe Ligjin Nr 9125, datë 29.07.2003.
16. Ligji Nr.9147, date 30.10.2003, “Për ratifikimin e Konventes Nr 155, të Organizatës Ndërkombëtare të Punës për “Sigurinë në punë, shëndetin dhe ambientet e punës “ 1981”.
17. Ligji Nr.9148, datë 30.10.2003, “Për ratifikimin e Protokollit të vitit 2002, të Konventës Nr.155 të Organizatës Ndërkombëtare të Punes për “Sigurinë në punë, shëndetin dhe ambientin e punës”1981”.
18. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.692, date 13.12.2001 “Për masat e vecanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë” ndryshuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 742, datë 06.11.2003.
19. Vendim i Keshillit të Ministrave Nr.207, datë 09.05.2002, “Për përcaktimin e punëve të vështira ose të rrezikshme”.
20. LIGJI Nr.8378, datë 22.7.1998 Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar)
21. SSH EN 14015:2004 “Specifikim për projektimin dhe prodhimin e rezervuarëve prej çeliku, me saldim, të montuar në vendin e instalimit, vertikal, cilindrik, me fund të sheshtë, të destinuar për depozitimin e lëngjeve në temperaturën e ambientit dhe më lart”;
22. SSH EN ISO 10423:2009 “Industritë e naftës dhe gazit natyror - Pajisje prodhimi dhe shpimi - Pajisja e grykës së pusit dhe armatura e fontanës (bredhit)” (ISO 10423:2009);
23. SSH EN 13175:2014 “Specifikimi dhe provat për ventilet dhe pajisjet e rezervuarëve të Gazit të Lëngëzuar të Naftës (GLN);
24. SSH EN 12819:2019 “Pajisje dhe aksesore për GLN - Inspektimi dhe rikualifikimi i rezervuarëve të gazit të lëngshëm të naftës (GLN) me kapacitet më të madh se 13m³”;
25. SSH EN ISO 21009-2:2015 “Enët nën presion kriogjenike. Enët statike të termoizoluara me vakum. Kërkesat e shfrytëzimit”;
26. SSH EN 12972:2018 “Çisterna për transportimin e mallrave të rrezikshme - Provat, inspektimi dhe shenjimi i çisternave metalike”;
27. SSH EN 1440:2016+A2:2020 “Pajisje dhe aksesore për GLN - Bombola për gazin e lëngët të naftës (GLN) që rimbushen, të transportueshme prej çeliku me saldim tradicional dhe me ngjitje - Inspektimi periodik”;
28. SSH EN 14894:2013 “Pajisjet dhe aksesoret për GLN - Shënimi i bombolave dhe fuçive”;
29. Metoda jo standarde “Rregullore e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike”.
30. KTP 15-78 “Instalimet elektrike në ambientet me rrezik zjarri”
31. KTP 16-78 “Mbrojtja nga shkarkimet atmosferike”
32. KTP 18-78 “Linjat ajrore të tensionit të latë”;

	33. KTP 19-78 “ Impiantet shpërndarëse dhe nënstacionet me tension mbi dhe në 1000V”; 34. V.K.M. Nr. 482, datë 17.6.2020 Për miratimin e rregullës teknike “Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së linjave elektrike me tension lartë mbi 1 kV”. 35. V.K.M. Nr. 483, datë 17.6.2020 Për miratimin e rregullës teknike “Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së instalimeve elektrike me tension lartë mbi 1 kV”. 36. SSH ISO 9927-1:2013 “Vinçat - Inspektimet - Pjesa 1: Të përgjithëshme” 37. SSH ISO 9927-3:2005 “Vinçat - Inspektimet - Pjesa 3: Vinçat kullë” 38. SSH ISO 4309:2017 “Vinça – Kavo - Kujdesi dhe mirëmbajtja, inspektimi dhe nxjerrja jashtë përdorimit” 39. ASME B30.5-2014 “Vinça të lëvizshëm dhe lokomotivë”
Periudha e vlefshmërisë:	Për fushat I – VI, deri më 06.11.2022 Për fushën sipas përcaktimit të pikës VII, deri më 28.12.2024
Teritori i ushtrimit të veprimtarisë:	Në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
Personi përgjegjës firmosës:	Majlinda Tafili, Julian Rapushi, Orges Mara dhe Veleidin Veliaj
Nr. Telefoni:	+355 696057977; +355 697073006; +355 693917050; +355 697418069
E-mail:	mtafili@swissapproval.al; jrapushi@swissapproval.al; omara@swissapproval.al;
OMVK regjistrohet me Nr. Identifikimi:	OMI 0 1 1 Rishikim 4

“Organi i Miratuar” i vlerësimit të konformitetit detyrohet të plotësojë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij kërkesat dhe kushtet e veçanta si më poshtë:

1. Është përgjegjës për veprimtaritë e vlerësimit të konformitetit, të kryera sipas objektit të tij të miratimit dhe çdo veprimtari tjetër të kryer, përfshirë veprimtaritë nënkontraktuese;
2. Nuk duhet të përfshihet në veprimtaritë që mund të krijojnë konflikt me pavarësinë/paanësinë e tij të gjyqimit ose integritetin për aktivitetet e vlerësimit të konformitetit, për të cilat ai është miratuar;
3. Siguron se veprimtaritë e degëve ose nënkontraktorëve të tij nuk prekin/ndikojnë në konfidencialitetin, objektivitetin, paanësinë e veprimtarive të tij të vlerësimit të konformitetit;
4. I siguron Ministrin, Strukturës Administrative Përgjegjëse (SAP), brenda 10 ditësh, kopje të certifikatave, raporteve të testeve dhe të vlerësimit të konformitetit, përfshirë dokumentet për to dhe informacionin për lëshimin, refuzimin ose tërheqjen e certifikatave për çdo subjekt;
5. Detyrohet të informojë Ministrin pa vonesë për çdo rast, në të cilin ky organ bëhet i paaftë të sigurojë përmbushjen e kushteve të vendosura për ushtrimin e miratimit të vlefshmërisë së konformitetit;
6. Informon brenda 5 ditësh Ministrin (SAP) për çdo refuzim, kufizim, pezullim ose tërheqje certifikate;
7. Informon Ministrin për çdo kërkesë për informacion, të cilën ai ka marrë nga Inspektorati Shtetëror në varësi të MIE-s për veprimtarinë e vlerësimit të konformitetit;
8. Detyrohet të mbajë regjistra të plotësuar rregullisht të të gjitha procedurave të vlerësimit të konformitetit, për të cilat ai është miratuar dhe të rezultateve të tyre për jo më pak se 10 vjet;
9. Me kërkesë të ministrit përgjegjës detyrohet të marrë pjesë në testime ose krahasime të tjera të

përcaktuara për OMVK-të;

10. Në fund të çdo periudhe katërmujore, detyrohet ti dërgojë Ministrit (SAP) regjistrin e inspektimeve ose certifikatave të lëshuara për periudhën në fjalë;
11. Organi i Miratuar detyrohet t'u krijojë akses të plotë punonjësve të SAP, të pajisur me urdhër të Ministrit, që të evidentojnë të gjitha të dhënat për përmbushjen e kërkesave të vlerësimit të konformitetit dhe të hyjnë në të gjitha ambjentet ku OMVK ka kryer vlerësimi të konformitetit, të përcaktuar në miratimin e lëshuar.

Në rast të konstatimit të mos plotësimit të kërkesave dhe kushteve sipas pikave 2, deri 11, ose në rast se organi i miratuar nuk arrin të përmbushë një apo disa kritere a kërkesa të përcaktuara në rregullat teknike përkatëse apo në rregullat për sigurinë e produktit/instalimit, të vendosur në shërbim/në përdorim dhe kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit, SAP i propozon Ministrit pezullimin e Aktit të Miratimit deri në afatin e dhënë për plotësimin e tyre.

Nëse Organi i Miratuar dështon në plotësimin e kushteve dhe kërkesave sa më sipër brenda afatit të caktuar, SAP përgatit dhe i paraqet për firmë Ministrit urdhërin për shfuqizimin e Aktit të Miratimit dhe heqjen e emrit të OMVK nga regjistri i organeve të miratuara.

Datë: 08/10 /2021

Ministri

BELINDA BALLUKU

